

## Kroçera “Ocean Majestic”, të martën në portin e durrësit.

27.09.2011

---



Të martën paradite në portin detar të Durrësit mbërrin për një vizitë 1-ditore anija kroçerë “Ocean Majestic”.

Që nga fillimi i këtij sezoni turistik në Durrës kanë ardhur me anije turistike më shumë se 6 mijë vizitorë, kryesisht nga Franca, Britania e Madhe, SHBA, Gjermania, Belgjika, Turqia, Rusia, etj.

Vetëm gjatë javës së kaluar në portin detar janë ankoruar 6 kroçera dhe superjahte. Turistët e huaj përveç qendrave arkeologjike në Durrës vizitojnë edhe qytetet e Tiranës dhe Krujës. Megjithëse qëndrimi i tyre në vendin tonë nuk zgjat më shumë se 14 orë, ata janë mjaft të interesuar për historinë dhe trashëgiminë tonë kulturore-bëjnë me dije drejtuesit e agjencive pritëse të udhëtimit.

Autoriteti Portual i Durrësit është kujdesur që kroçerat të ankorohen në kalatat 4 dhe 5, çka lehtëson edhe lëvizjen e tyre në këmbë drejt qytetit.

Që prej 3-4 vitesh Durrësi është një destinacion i preferuar turistik dhe numri i kroçerave që vizitojnë portin detar në kuadër të tureve Mesdhetare disaditore ka ardhur në rritje. Gjatë këtij sezoni veror në portin më të madh të vendit janë ankoruar kroçerat dhe superjahtet “Arion”, “Kristina Katarina”, “Island Sky”, “Clipper Odissey”, “Panorama”, “Pegasus” dhe “Ocean majesty”, të cilat kanë kryer 28 lundrime gjithsej drejt Durrësit. Në kalatat e portit janë ankoruar gjithashtu dhjetra jahte dhe barka të vogla me vela.

